



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të dëgjimit publik të përgjithshëm, mbajtur më 22.12.2022, duke filluar në orën 17:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Qendrim Vitija, Shpresë Blakçori, Kujtim Bërbatovci, Skender Sylejmani, Xhemshir Cakolli, Bajram Shala, Denis Mehmetaj, Lance Johnston, Riga Gjata, Luan Gjata, Shenoll Ismaili, Adonis Mustafa, Naime Zylfiu, Kadri Zylfiu, Jetullah Gashi, Sokol Berisha, Qerim Sharbani, Afrim Reçica, Orhan Avdiu, Gjengiz Ismaili, Petrit Haskaj, Shkumbin Hetemi, Astrit Ajeti, Arsim Sefedini, Rifat Deri, Naim Gashi, Egzon Gashi, Bahri Gashi, Mensur Arifi, Xhavid Gjigoli, Naim Mehmeti, Adem Gashi, Milot Krasniqi, Faton Maliqi, Sahit Shillova, Besim Pasjaqa, Përparim Gashi, Skender Mehmeti, Hava Mehmeti, Shaip Hajrizi, Ramë Rama, Avdi Aliu, Xhafer Cakolli, Ismet Haziri, Naser Gashi, Bajram Sopi, Rexhep Miftari, Ismet Krasniqi, Avdyl Gashi, Rama Cakiqi, Skender Berisha, Fatos Dili, Nexhat Behxheti, Elmire Nikçi-Rexha, Amir Simnica, Granit Geci, Fatmir Dervishi, Leutrim Retkoceri dhe Arlind Uka.

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donika Çeta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bujar Çunaku, përfaqësues nga Drejtoria e Pronës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**.

**Osman Bllaca**, përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, i cili tha se diskutimi i sotëm ka të bëjë me diskutim të përgjithshëm, për tema të lira të cilat juve ju interesojnë, secili projekt ku ndodhet, në cilën fazë gjendet dhe për secilin aktivitet të komunës i cili është kryer dhe është në proces të përfundimit.

**Përparim Rama**, kryetar përshëndeti të gjithë, duke i falënderuar për pjesëmarrje në dëgjim publik. Ai tha se përtej obligimeve ligjore, ideja është që të komunikojmë së bashku për të mirën e qytetit, të ju dëgjojmë edhe juve për nevojat e kryeqytetit. Shpresoj që sonte do të jetë një bisedë konstruktive, të marrim shënime, të bashkëbisedojmë për çka do që ju intereson dhe për çfarë do

ide që mendoni që janë të nevojshme për qytetin tonë për komunitetin, për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Prishtinës.

**Qerim Sharbani**, tha se Drejtoria e Kadastrit dhe Drejtoria e Pronës, duhet me i evidentuar por kemi edhe prona publike. Unë jam uzurpator i një pjese të asaj prone publike, kamë diku 80 hektarë. Për fshatin tim duhet të bëhet infrastruktura rrugore, ujësjellës, kanalizim, ndriçim. Fshatrat tona nuk munden me pas as kanalizim, as ujësjellës, as ndriçim kështu ato janë të shpërndara. Gollakut i mungon rrjeti i ujësjellësit, e që ky projekt është premtuar nga Komuna dhe deri më tani nuk po realizohet.

Po ashtu kisha propozuar një pikë të aeroportit me e vendosur diku në zonën e Gollakut mundësisht diku në vendet të "Suka e Radashevcit" ose në "Stallovë". Qytetit gjithashtu i mungon rrjeti i hekurudhës, si dhe do të ishte mirë që të jetë edhe një teleferik për pjesët periferike të qytetit.

Si ide e imja po ashtu kishte me qenë edhe një linjë e tramvajit prej Fushës së Pajtimit të vazhdohet deri në Grashticë, pastaj del në Mramor, busi dhe shkon pranë liqenit të Badovcit, vjen në Hajvali dhe vazhdon deri në aeroport.

**Shaip Hajrizi**, qytetar i lagjes "Kodra e Trimave", tha se gjatë këtij viti kam përcjellë punët dhe jam i kënaqur me at se çka është bërë në Komunën e Prishtinës. Unë i kam dy pyetje, e para ka të bëjë me strehimoren e qeneve dhe kthimin e përgjigjes negative nga Ministria e Ambientit. A mendoni që ju mundeni me gjet një strehimore tjetër dhe a do të përfundoj ajo punë definitivisht dhe kur. Cili është plani i juaj dhe kur do të filloi ndërtimi për "Tregun e gjelbër".

**Rifat Deri**, tha se në mandatin e kaluar e kemi një vendim të cilin e kemi aprovuar me vota unanime për caktimin e lokacionit të ngritjes së lapidarit kushtuar vrasjeve të Prishtinës në 5-vjeçarin e parë të luftës së dytë botërore, ose siç e quajnë prishtinasit e vjetër " Në Strelishtë". A do të shihet në buxhet që ky projekt të jetësohet.

Po ashtu çfarë hapa do të ndërmerri për krijimin e Komisionit për riemërtimin e rrugëve dhe institucioneve në Komunën e Prishtinës. Gjithashtu kërkoi të dijë se ne e kemi ngritur një çështje për ndërrimin e emrit të bibliotekës e cila ka qenë "Hivzi Sylejmani", i cili ka qenë gjykatës në vitin 1945 dhe i ka dënuar shqiptarët me vrasje dhe burgim të rëndë, dhe sot biblioteka e qytetit quhet "Hivzi Sylejmani".

Unë mendoj se nuk e meriton qyteti i Prishtinës, biblioteka të ketë një emër të atij personi i cili edhe sipas dokumentacionit, i keni të gjitha të dokumentuara që ka qenë gjykatës që i ka dënuar shqiptarët me vdekje dhe me burgim të rëndë.

**Naser Gashi**, qytetar nga lagja "Bregu i Diellit", tha se në takimet që kemi prezantuar më herët kam propozuar që Kuvendi i Komunës ta miraton një rregullore për bizneset tona që shesin dhe ekspozojnë mall në rrugë, pra hartimin e një rregulloreje që ju ndalohet shitja në trotuare-rrugë. Po ashtu propozoi që kur të jepen lejet për ndërtimin e objekteve të ai objekt ta ketë vendin për vendosjen e kontejnerit për mbeturinat e objektit.

Po ashtu kërkoi nga përgjegjësit e Komunës që të lirojnë hapësirat për lëvizjen e këmbësorëve, pasi që po pengohen nga parkimi i veturave, si dhe kërkoi që të bëhet ndriçimi i rrugës "Parashqevi Qiriazit", të Banosat e Bardha, në lagjen "Velania", është më se urgjente pastrimi i parqeve.

Është për keqardhje që f[ashti Butovc nuk e ka asnjë metër të asfaltuar. Një shqetësim që duhet ngritur është edhe vendimi i marrë i viteve 1979-1980, objektet që janë rreth shkollës "Iliria", kanë mbet peng që 40 vjet dhe ato prona janë pa pronar legjitim. Po në vitin 2013, ky Kuvend, ka marr vendim që Butovci të hynë zonë e gjelbër dhe zonë e mbrojtur, mendoj se këto qëndrime dhe vendime nuk kanë bazë ligjore dhe i dëmtojnë në masë qytetarët e atyre zonave.

**Skender Sylejmani**, qytetar nga lagja "Kodra e Diellit 2", tha se ne qytetarët e kësaj lagje më se tri herë kemi bërë kërkesë për takim me Kryetarin e Komunës, mirëpo deri sot asnjëherë nuk na ka dërguar asnjëherë një ftesë për tu takuar. Arsyeja është se në vitin 1985 është bërë eksproprijimi, por deri më sot më se 52 familje nuk jemi shpronësuar, nuk jemi paguar. Si është e mundur që të ndodhë kjo.

**Ismet Haziri**, qytetar nga periferia e Prishtinës tha se a ka mundësi që bizneset të mos punojnë në dëme të kohës tonë dhe në dëm të krijimit të katrahurës në trafik. Kërkoj që trotuaret të jenë të lira dhe ato të mos pengohen nga parkingu i veturave.

**Shenoll Ismaili**, qytetar nga lagja "Medreseja", tha se jemi të interesuar me ditë se a ka mundësi që neve aty të na lejohet ndërtimi i lartë ose ndërtimi kolektiv.

**Avdi Aliu**, përfaqësues nga fshati Keçekollë tha se në sezonin e dimrit rrugët në këtë zonë nuk mirëmbahen dhe ajo zonë malore bllokohet çdo herë gjatë dimrit andaj kisha pas dëshirë që ajo të jetë prioritet të paktën ato që janë të asfaltuara.

Po ashtu kërkoj që të ndërtohet një rrugë deri te "Kalaja e Keçekollës".

Gjithashtu tha se është një shtëpi që ish dashtë të restaurohet edhe të futet në projekt edhe restaurimi i varrezave të asaj masakre që kanë ndodhur në fshatin Keçekollë (1921) dhe që janë edhe ato duke u zhdukur.

**Adem Gashi**, qytetar nga zona "Qendër", tha se shkallët në lagjen "Arbëria", aty ku përfundojnë janë vendosur disa pengesa dhe është mbyllur rruga. Çfarë kuptimi ka me qenë shkolla atje, me qenë çerdhja atje nëse këtyre banorëve për të cilët është ndërtuar ajo shkollë e ajo çerdhe, ju mbyllet rruga.

Deri ku do të shtrihet rrjeti i ngrohtores në qytet, konkretisht te banesat "Butrinti".

**Avdyl Gashi**, qytetar dhe në cilësinë e drejtorit të OJQ "Global Shapers-Prishtina", tha se në qytet janë disa dukuri të cilat për mua janë pengesë, siç mishtoret të cilat i kanë xhamat transparent dhe e vendosin aty për reklamë shtazët e rrjepura dhe mendoj është një gjë skandaloze për ne si qytetar na traumatizon e mos të flasim për turistët. Ngjashëm me këtë janë edhe restorantet e ndryshme që kanë pula të pjekura etj.

Kisha propozuar që rrugën "Ahmet Krasniqi", prej Amadeusit deri të semaforët të objekti i ri i Komunës, me qenë një kahëshe.

Po ashtu si çështje që dua ta ngriti është edhe çështja për bursa për nxënësit e shkollave të mesme, ku mendoj që ishte dashtë të e krijojmë një rregullore të bursave për nxënësit. Po ashtu do të ishte mirë që Prishtina me e pas një qendër- hapësirë për të rinjtë.

**Sahit Shillova**, banor nga fshati Zllatar, po ashtu edhe pronar i restorantit “Kulla”, ngriti një shqetësim rreth punimeve në rrugën kryesore për në fshatin Zllatar i cili tha se që nga fillimi i punimeve në rrugë, ne vazhdimisht kemi pasur pengesa në biznes, ku veç jam në prag të falimentimit nga neglizhenca e një kompanie, apo një punekryerësi, apo mos menaxhimi i mirëfilltë i zyrtarëve komunal, për mos realizimin e projektit të rrugës.

**Bajram Sopi**, qytetar në lagjen “Kalabria”, tha se shqetësimi i banorëve të kësaj lagje ka të bëjë rreth disa gabimeve gjatë hartimit dhe përpilimit të Planit Zhvillimor Urban për atë pjesë, ku ka disa defekte, edhe kryetari e ka marrë përsipër që ato do të rregullohen, si ato të rrugët, të infrastruktura, të shkolla, çerdhja etj. Po ashtu qytetarët janë të pa kënaqur edhe rreth përcaktimit të koeficientit.

Gjithashtu edhe në emër të qytetarëve të fshatit Butovc, ngriti një shqetësim rreth një plani që atë zonë e definon si zonë gjelbërimi, kështu që banorëve u pamundësohet ndërtimi edhe në pronat e tyre. Kërkoj që edhe për këta banorë të jetë një kriter që u lejon ndërtimin.

**Milot Krasniqi**, banor i lagjes “Kalabria”, ngriti një shqetësim rreth përcaktimit të koeficienteve të ndërtimit në këtë lagje i cili tha se cilët janë ata ekspertë që do ta caktojnë koeficientin e ndërtimit, pasi që neve na është premtuar publikisht që koeficienti do të jetë më i lartë se 2.4. Po ashtu kërkoj që rruga “Dëshmorët e Ponoshecit”, të sanohet, sepse është dëmtuar shumë.

**Xhafer Cakolli**, banor nga periferia e qytetit kërkoj të dijë se kur do të funksionoj linja e trafikut urban për rrugën “Sheshi i Arbërit”, që e lidhë me rrugën “Tomori”, premtim i dhënë nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Kur do të rregullohet Parku i qytetit, pasi që një pjesë e tij është dëmtuar shumë nga qytetarët, si dhe deri ku ka mbërritur procedura rreth ndërtimit të Spitalit të qytetit.

**Një qytetar** nga lagja “Kalabria”, kërkoj të dijë se vija e hekurudhës e cila kalon prej “Tjerrtores” deri te “Rrethi i Madh”, a është në plan të de-aktivizohet ajo hekurudhë apo jo, dhe a ka me u ndërtuar ndonjë rrugë e re aty.

**Faton Maliqi**, banor nga Prishtina, po ashtu pronar i një parcele në lagjen “Kalabria”, tha se parcela ime në bllokun C 5 ka mbet komplet pa qasje në rrugë. A ka mundësi që un të kam qasje në rrugë.

**Lance Johnston**, banor në rrugën “Fehmi Agani”, shtroi pyetjen në lidhje me sigurinë e ndërtesave ekzistuese që janë transformuar prej rezidencave në restorante. Një numër i madh i këtyre rezidencave kanë pësuar edhe ndryshime strukturale, që krijojnë një nivel të rrezikshmërisë në rast të tërmeteve. Po ashtu edhe restorantet te cilat përdorin bocat e plinit, për qytetarët paraqesin një rrezik të madh.

**Adonis Mustafa**, banor në lagjen “Medreseja”, rruga “Lidhja e Prizrenit” tha se do të ishte mirë që të rritet koeficienti i ndërtimit edhe për këtë lagje, po ashtu të bëhet pastrimi nga mbeturinat e ndryshme që janë prezent, si dhe kërkoj që të lëshohet në qarkullim edhe një linjë e trafikut urban.

**Skënder Mehmeti**, banor nga Prishtina tha se që 13 vite kam një problem me një parcelë në zonën “Prishtina e Re”, zona perëndimi konkretisht në lagjen “Qëndresa”, e që kjo pjesë nuk është marr

për bazë gjendja faktike që ka qenë në terren, kanë qenë rruga, kanalizimet të gjitha janë të përfunduara dhe aty është bërë lëvizja e kufijve, kështu edhe përkundër ankesave që kemi bërë, jemi dëmtuar në masë.

**Kadri Zylfiu**, banor afër ish -shkollës Teknike, ku ne banorët afër rrugës "Antigona Fazliu", 99 pronarë kemi nënshkruar dhe e kemi dorëzuar në Komunë një kërkesë që të na lejohet ndërtimi kolektiv.

**Amir Simnica**, banor i lagjes së "Muhaxherëve", edhe anëtar i Kuvendit të Komunës tha se kryetari Përparim Rama, ka pasur një fokus të veçantë për të bërë investime shumë të mira në këtë lagje, si kyçje me rrjetin e "Termokosit", ndriçimin dhe rregullimin e rrugëve etj.

**Naim Mehmeti**, banor i Prishtinës tha se në lagjen "Kalabria", përkatësisht në rr. "Ali Vitia", që është paralel me rrugën që ngjitet lart Veternikut e cila rrugë është e përfunduar pikërisht të parcela ime dhe a ka mundësi që kjo rrugë të vazhdoi edhe më tutje. Po ashtu a mendohet që të ndërtohet ndonjë mbikalim apo nënkalinim në lagjen "Kalabria", aty përballë të "Albi mall". A ka ndonjë zgjidhje urbanistike që unë ta ndërtoj një objekt në këtë zonë.

A ka mundësi që në rrugën "Prekazi", që lidhet me rrugën "Muharrem Fejza", të vendosen disa shtylla që mos të parkohen aty automjetet.

Po ashtu kam bërë një kërkesë për ndërtimin e një shtëpie në lagjen "Sofalia" ku kanë kaluar më se 9 muaj skam marr përgjigje.

**Petrit Haskaj**, banor i Prishtinës tha se cila është arsyeja që i kanë mbledhë të gjithë shitësit ambulant dhe i kanë sjellë te rruga "Fehmi Agani", më saktësisht tek sheshi Nëna Terezë", tek busti dhe në rrugën "Hajdar Dushi".

**Një qytetar** nga lagja "Ulpiana", banor te blloku D/5 kërkoi të dijë se me aplikimin e rregullores së re për "Prishtina Parking", a duhet të mbikëqyret i tërë parkingu i këtij blloku, kështu që neve banorët e bllokut tjetër të mos na zënë hapësirat për parking.

**Bahri Hoxha**, banor nga fshati Shkabaj, imam në "Xhaminë e Madhe" tha se i kemi bërë disa kërkesa në emër të fshatit si për shkollën, për parkun rekreativ të fshatit dhe zgjerimin e rrugëve, por krahas këtyre kërkesave kemi bërë kërkesë edhe për caktimin e një lokacioni për ndërtimin e një xhamie në fshat dhe kemi propozuar që pikërisht aty ku po ndërtohet parku nga Komuna e Prishtinës aty afër të na caktohet një lokacion.

Lidhur me pyetjet, kërkesat dhe sugjerimet e dhëna nga qytetarët, përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar, Mimoza Sylejmani, drejtore, Izet Sadiku, drejtor dhe Granit Rugova, drejtor.

**Procesmbajtësi**  
**Arton Brahimi**

**Kryesuesi i takimit**  
**Osman Bllaca**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Diskutim i përgjithshëm publik,  
22 Dhjetor, 2022  
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Remzim VITIA	VITIA	—		
2	SHPREŠE	BLAKORI	—		
3	Kujtim	Bërhatovci	—		
4	Skender Sygymari		—		
5	Xhemal	Çavolli	—		
6	BEJRAM	SHAROR			
7	Denis	MEHMETAJ	—		
8	LANCE	JOHNSTON			
9	Riga	Gjata	—		
10	Luan	Gjata	—		

*P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*

*\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!\**



Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	SHENOLL	ISMAILI			
12	ADONIS	MOSTAFA			
13	Naime	Zulfin			
14	HADRI	ZYLFIU			
15	Jetollah Gashi	GASHI			
16	SOKOL BEKISHI	BEKISHI			
17	Qazim Rexha	K.B.L. LLUKAJ			
18	Ajrim	Reçiu			
19	Orion	Avdiu			
20	Gengiz	ismaili			
21	PETRI T	HASKAJ			
22	SHKUMBIN	HETEMI			
23	ASTREIT	AJETI			
24	Ajrim	Sefedini			
25	Kifet	Deri			
26	NAIM	GASHI			
27	Egzon	Gashi			
28	Bohri	Gashi			

P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!\*

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
29	Mensur	AKIFI			
30	XHAVID	GTIGOLI			
31	Armin	Melubi			
32	Adem	Gashi			
33	Milot	Trasna			
34	Faton	Majiqi			
35	SAHIT	SHILLOVA			
36	Beqir	Paçaj			
37	VEPARI	GAZI			
38	SKENOC	MEHMUTI			
39	Hava	Mekuqi			
40	Shqip	Hijri			
41	SHKURTI				
42	Avdi Aliu				
43	XHAFER CAKOLLI	CAKOLLI			
44	ISMET	HAZIKI			
45	Naser	Gashi			
46	Beqir	SOPU			

**P.S** \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!\*



Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
47	REXHET	MIFTAR			
48	Ismet	Krasniqi			
49	Avdyll	GASHI			
50	RAMA	CHAKI			
51	SKENDER	BERISHA			
52	FATOS DILI				
53	NEXHAT	DEHXHETI			
54	ELMIRE	NIKI - REXHA			
55	AMIR	SIMNICA			
56	GRANI	BEG			
57	FATMIR	DERVIHI			
58	Leutrim	Rehceri			
59	ARLIUD	UKA			
60					
61					
62					
63					
64					

**P.S** \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!\*